

Ekonomistët e Unia propozojnë nismën kundër papunësisë masive në Evropë

Më shumë vende punë në vend të rritjes së profitit

Cili është problemi më i madh i Evropës? Refugjatët? Ngritja e partive të ekstremistëve të djathtë? Moti i nxehtë? Rrëzimi i urave të autostradave? Asnjë nga këto. Ekonomistët e Unia e thonë shkurt e qartë: Është papunësia.

Rreth 14 miliona njerëz kanë përfunduar në rrugë dhe nuk mundur të gjejnë një punë tjetër. Ata janë në siklet, varen nga shteti dhe shpesh zhytet në depresion. Por ky fakt nuk zgjon interesim tek politika.

Të investohet në punësim

Korporatat duhet më në fund të riinvestojnë dhe të krijojnë më shumë vende pune në vend që të devijojnë fitimet e tyre të larta në xhepat e menaxherëve dhe aksionarëve. Punësimi i plotë ishte dikur tema më të mëdha dhe më të rëndësishme të lëvizjes punëtore. Qysh në vitet 1970, ky edhe ishte qëllimi i vetëkuptueshëm i çdo politike ekonomike

Më shumë se një ëndërr në diell

Por pastaj fjala për punësimin e plotë u zhduk qetësisht nga fjalori politik. Sipas llogaritjeve të Baumann dhe Bucheli, në BE do të duhej të krijohej 12 milion vende të reja pune. Kështu papunësia do të binte nën pragun dy për qind dhe do të mund të flisnim për punësim vërtet të plotë. Baumann dhe Bucheli duan që të plasojnë idenë e tyre tek federatat ndërkombëtare të sindikatave.

Ideja i shërben edhe Zvicrës

Kërkesë-parashtresa për punësim të plotë gjithashtu do të sjellte perfitime edhe punonjësve të Zvicrës, si vend jo-BE. Çdo i dhjetë vend-punë në Zvicër vjen nga një korporatë shumëkombëshe me seli jashtë vendit. Zvicra, sipas parashikimeve do të bashkohej vullnetarisht këtij objektiv punësimi. Kjo do të parandalonte që vendet e punës të transferoheshin në vendet e BE-së. Baumann gjithashtu sheh efekte pozitive mbi migracionin brenda Evropës: «Nëse ka punësim të plotë, atëherë do të thotë që njerëzit gjejnë punë në vendin e tyre dhe nuk kanë nevojë të emigrojnë».

